



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:065074

Datë: 28.01.2019

Numri i dokumentit: 00213780

PKR.nr. 122/18

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues - gjyqtari Artan Sejrani, me procesmbajtësen Florije Kolukaj, sekretare juridike, në lëndën penale kundër të pandehurve S.K nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 parag. 1 të KPRK-së dhe L.Gj nga Prizreni, për shkak të veprës penale, dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 388 parag. 2 nën parag. 2.8 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda PP/I.nr.140/18 të datës 26.12.2018, në shqyrtim fillestar, duke vendosur mbi marrëveshjen e pranimit të fajësisë, në praninë e Prokurorit të shtetit Metush Biraj, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre av. F.Sh dhe Sh.B që të dy nga Prizreni, me datë 23.01.2019 publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1. S.K, nga i ati A, dhe e ëma R, e lindur V, i lindur më datën..., në Prizren, ku edhe tani jeton, i pa martuar, ka të kryer shkollën e fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Republikës së Kosovës, me numër personal...

2. L.GJ, nga i ati Q, dhe e ëma F, e lindur G, i lindur me datën ... në Prizren, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar baba i 3 femive, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, me numër personal...

JANË FAJTORË

I pandehuri S.K:

I. Pa autorizim në vazhdimësi ka ofruar për shitje - shpërndarje ose poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, substanca psikotrope apo substanca analoge, në atë mënyrë që me datën 08.08.2018, të objekti i qendrës së paraburgimit në Prizren, të paraburgosurve në brendi të objektit të qendrës gjegjëse, u ka gjuajtur substanca narkotike të llojit "marihuan", të paketuara në qese najloni të mbështjella me gurë, ku katër qese prej tyre në peshë prej 38.49 gr, kanë mbetur në kulmin e ndërtesës, e pastaj me datën 30.10.2018, rreth orës 08:00, për qëllim të njëjtë, në shtëpinë e dhëndrit L.Gj, në Prizren, saktësisht në një valixhe të zezë, të motrës së tij - bashkëshortes së L, nën dyshek të shtratit të dhomës së fjetjes i ka fshehur 9 (nëntë) paketime substancë narkotike të llojit "Marihuan", të mbështjella me najlon, në peshë të përgjithshme rreth prej 3.670,2 gr, dhe një paketim me rizlla që shërbejnë për mbështjellje në formë të cigares të narkotikut gjegjës.

Këso dore ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 parag. 1 të KPRK-së.

I pandehuri L.Gj:

II. Ka ndihmuar në fshehjen e provave në atë mënyrë që me datën 30.10.2018, në shtëpinë e tij, në Prizren, ia ka mundësuar që vëllait të bashkëshortes së tij të akuzuarit S.K, në një valixhe të zezë nën dyshek të shtratit të dhomës së tij të fjetjes, ti fsheh 9 (nëntë) paketime të mbështjella me najlon, me substancë narkotike të llojit "marihuan", në peshë të përgjithshme prej 3.670,2 gr, dhe në paketim me rizlla që shërbejnë për përdorim të narkotikut në fjalë.

Këso dore ka kryer veprën penale dhënia e ndihmës kryrësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 388 parag. 2 nën parag. 2.8 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 22, 41, 42, 43, 45, 46, 69, 73, nenit 273-1 dhe 388-2-2.8 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurit i :

GJYKON

- Të pandehurin S.K, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **20 (njëzetë) muajve** si dhe me dënim me gjobë në shumë prej **500 (pesëqind) euro**.
- Të pandehurin L.Gj, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve, në kuptim të nenit 47 të KPRK-së, me pëlqim të pandehurit zëvendësohet dënimi me burgim me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 30.10.2018 deri me datën 26.11.2018.**

- Të pandehurit obligohen që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ti paguajnë dënimet e shqiptuara me gjobë. Në rast se të pandehurit nuk i paguajnë dënimet me gjobë apo nuk mundet ti paguajnë, dënimet me gjobë do t'iu zëvendësohen me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do t'iu caktohet një ditë burgim.
- Nga i pandehuri S.K konfiskohet marihuana në peshë prej 38.49 gr, dhe 3.670,2 gr, dhe një paketim me rizlla.
- Obligohen të pandehurit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë secili veç e veç paushallin gjyqësor në lartësi me nga 100 euro, si dhe secili veç e veç me nga 50 euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr.140/18 të datës 26.12.2018 kundër të pandehurve S.K nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 prag. 1 të KPRK-së dhe L.Gj nga Prizreni, për shkak të veprës penale, dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 388 parag. 2 nën parag. 2.8 të KPRK-së.

Pas ngritjes së aktakuzës Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, në gjykatë ka parashtruar marrëveshjen për pranimin e fajësisë PP/I.nr.140/2018 të datës 26.12.2018.

Gjykata, në seancën e shqyrtimit fillestar në pajtim me dispozitat e nenit 247 të KPP-së ka shqyrtuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ku ka dëgjuar të pandehurit, mbrojtësit e tyre si dhe Prokurorin e shtetit lidhur me pretendimet e tyre sa i përket marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Sa i përket gjendjes faktike gjykata e ka vërtetuar ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e aktakuzës në kushtet dhe rrethanat ligjore të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit gjatë seancës ka deklaruar se me të pandehurit S.K dhe L.Gj në përputhje me ligj dhe duke u bazuar në kërkesën e tyre, në prezencë të mbrojtësit të tyre dhe pasi që janë njoftuar me ofertën e prokurorisë, të njëjtit në konsulte me mbrojtësit të tyre, pas negocimit kanë hyrë në marrëveshje për pranimin e fajësisë, normalisht duke ju shpjeguar paraprakisht nga prokuroria dhe nga avokatet natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pasi që janë bindur se të njëjtit janë të vetëdijshëm dhe me vullnet kanë hyrë në këtë marrëveshje dhe janë pajtuar me rekomandimin e propozuar të dënimit, të njëjtit e kanë nënshkruar marrëveshjen. Andaj gjykatës i propozon që kjo marrëveshje në përputhje me rekomandimet të aprovohet.

Mbrojtësi i të pandehurit S.K, avokati F.Sh, ka deklaruar se meqenëse i pandehuri S.K e ka shprehur dëshirën që vullnetarisht të hynë në marrëveshje për pranimin e fajësisë, me datën 23.12.2018, kemi parashtruar prokurorit të shtetit kërkesën që të hymë ne negociata për arritjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, e cila është arritur me datën 26.12.2018, andaj propozoj që e njëjta të aprovohet nga ana e gjykatës.

Mbrojtësi i të pandehurit L.Gj, Sh.B, ka deklaruar se nuk e kundërshton marrëveshjen të cilën e kam arritur me prokurorinë me datën 26.12.2018, dhe i propozoj gjykatës që kjo marrëveshje të aprovohet.

I pandehuri S.K, ka deklaruar se paraprakisht më është shpjeguar aktakuza dhe pas shpjegimit të aktakuzës nga mbrojtësi dhe nga prokurori, jam njoftuar me të gjitha të drejtat. Këtë marrëveshje e kam nënshkruar vullnetarisht pa kurrfarë presioni. Këtë marrëveshje e mbështesë dhe se kërkoj nga gjykata që të aprovoj pasi që paraprakisht edhe nga gjykata me janë shpjeguar favorët dhe disfavorët e kësaj marrëveshje. Përfundimisht deklaroi se këtë marrëveshje e kam nënshkruar në mënyrë vullnetare dhe qëndroj në tërësi pranë kësaj marrëveshje .

I pandehuri L.Gj, ka deklaruar se paraprakisht më është shpjeguar aktakuza dhe pas shpjegimit të aktakuzës nga mbrojtësi dhe nga prokurori, jam njoftuar me të gjitha të drejtat. Këtë marrëveshje e kam nënshkruar vullnetarisht pa kurrfarë presioni. Këtë marrëveshje e mbështesë dhe se kërkoj nga gjykata që të aprovoj pasi që paraprakisht edhe nga gjykata me janë shpjeguar favorët dhe disfavorët e kësaj marrëveshje. Përfundimisht deklaroi se këtë marrëveshje e kam nënshkruar në mënyrë vullnetare dhe qëndroj në tërësi pranë kësaj marrëveshje .

Gjykata pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre, lidhur me pranimin e fajësisë, sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, konstatoi se të pandehurit, e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të pandehurit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tyre, të pandehurit nuk ka qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë të pranuar edhe nga të pandehurit, dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e nenit 253 par. 1 dhe 2 të KPP-së, për hedhjen e aktakuzës.

Gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është lidhur në pajtim me nenin 233 par. 18 të KPP-së dhe të njëjtën e ka pranuar.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurve, formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale, të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të pandehurit ti shpallë fajtor dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale-juridike të tij.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se qëndron pranë dënimit të rekomanduar si në marrëveshje.

Mbrojtësi i të pandehurit S.K av. F.Sh ka deklaruar se meqenëse sot nga ana e gjykatës është pranuar marrëveshja për pranimin e fajësisë. Propozon që gjykata gjatë shqiptimit të dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese nga neni 73, 74, 75, të KPP-së, sidomos rrethanën se i pandehuri ka bashkëpunuar me organet si dhe e ka shëndetit jo të mirë.

Mbrojtësi i të pandehurit L.Gj av. Sh.B ka deklaruar se në tërësi e mbështetë marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe dënimin e rekomanduar.

Të pandehurit pajtohen me theksimet e mbrojtësve të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana renduese, e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, moshën e tyre, arsimimin e tyre, gjendjen ekonomike të tyre, andaj gjykata iu shqiptoj dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke menduar se dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Krimeve të Rënda

PKR.nr.122/18 të datës 23.01.2019.

**Procesmbajtësja
Florije Kolukaj**

**Kryetari i trupit gjykues,
Artan Sejrani**

UDHËZIM JURIDIKË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.